



Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova /  
Kosovo Prosecutorial Council



Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

# KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR PROKURORË







Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Tužilački Savet Kosova  
Kosovo Prosecutorial Council



Prokurori i Shtetit  
Državni Tužilac  
State Prosecutor



Duke pasur parasysh standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat i garantojnë në mënyrë specifike secilit individ barazinë parimore para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur, e krijuar me ligj;

Duke u bazuar në Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Pushtetit Gjyqësor, të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor të vitit 1985, si dhe në udhëzimet për rolin e prokurorëve, të adoptuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimin dhe Trajtimin e të Pandehurve;

Duke u bazuar në Rekomandimin nr. R (19) 00 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtare për rolin e prokurorit publik në sistemin penal të drejtësisë;

Duke pranuar që Prokurori i Shtetit luan një rol themelor dhe bartë përgjegjësi të rëndësishme në administrimin e drejtësisë në emër të shoqërisë dhe interesit publik dhe është veçanërisht përgjegjës për të siguruar zbatimin e ligjit në rastet kur shkelja e ligjit sjell për pasojë sanksione penale, duke pasur parasysh në çdo rast të drejtat e individëve dhe efikasitetin e nevojshëm të sistemit penal të drejtësisë;

Duke pasur parasysh që sjellja etike dhe perceptimi i sjelljes së duhur etike janë esenciale për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të një anëtari të sistemit prokurorial;

Duke ditur që në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, prokurorëve u garantohet liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit, sikurse çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, prokurori duhet gjithmonë të sillet në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin e zyrës, paanësinë dhe pavarësinë e institucionit prokurorial, dhe

Duke pasur parasysh që parimi i ndarjes së pushtetit respektohet në lidhje me detyrat e prokurorit dhe aktivitetet jashtë lëmisë penale dhe në mënyrë që të sigurohet roli i gjykatës në mbrojtjen e drejtave të njeriut;

Të vetëdijshëm për nevojën për të miratuar dispozita që synojnë të mbështesin efikasitetin, pavarësinë, paanshmërinë, transparencën dhe drejtësinë e prokurorëve të Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në mbështetje të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 4, paragrafi 1, pika 1.19 Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, miraton:

*KODIN E ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE  
PËR PROKURORË*

# PËRMBAJTJA

Qëlimi.....	6
Fushëveprimi.....	6
Parimet e përgjithshme.....	6
1. Pavarësia.....	8
2. Paanshmëria.....	10
3. Integriteti.....	12
3.1. Konfidencialiteti.....	16
4. Llogaridhënia dhe transparenca.....	18
4.1. Transparenca dhe mediat.....	19
5. Profesionalizmi.....	20
6. Zbatimi dhe hyrja në fuqi.....	22

## Qëllimi

Kodi i Etikës ka për qëllim të përcaktojë standardet e sjelljes dhe etikën e prokurorëve, duke u bazuar në vlerat dhe parimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje KPK) dhe Prokurorit të Shtetit, siç janë: pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi.

## Fushëveprimi

Kodi i Etikës përmban rregulla të sjelljes dhe etikës të obligueshme për të gjithë prokurorët e shtetit dhe nuk paraqet zëvendësim, por plotësim të akteve të tjera, të cilat rregullojnë këtë fushë.

Kodi i Etikës i përshtatet pozitës së prokurorëve dhe përgjegjësive të ngarkuara të tyre, duke ofruar pika konkrete të referencës se si duhet të veprojnë në detyrë dhe jetën private.

## Parimet e përgjithshme

Prokurorët do të punojnë për të realizuar mandatin e tyre, duke u bazuar në parimet e përgjithshme dhe themelore të etikës profesionale, si në vijim:

1. Format specifike të sjelljes së pahijshme të prokurorëve, të përfshira në këtë kod, nuk janë gjithëpërfshirëse. Është e pamundur që



- të ofrohet një listë e plotë e të gjitha situatave, me të cilat prokurori mund të përballet në praktikë;
2. Rregullat e pashkruara për vlerësimin e situatës përkatëse duhet të jenë të tilla që çdo sjellje që dëmton nderin dhe dinjitetin e Prokurorit të Shtetit dhe mund të dëmtojë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e tij, duhet të shmanget nga prokurori gjatë gjithë kohës;
  3. Prokurori gjatë gjithë kohës, në të gjitha rrethanat, në detyrë dhe në jetën private duhet:
    - 3.1. T'i respektojë standardet e larta të sjelljes profesionale dhe personale;
    - 3.2. T'i kryejë detyrat me paanshmëri dhe kujdes;
    - 3.3. Të shmangë çdo sjellje dhe situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë;
    - 3.4. Ta respektojë dhe t'i përmbahet ligjit;
    - 3.5. T'i kryejë detyrat e tij bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
  4. Në raste kur prokurori ballafaqohet me rrethana, në të cilat nuk është e qartë se si të vepron, është e rëndësishme që prokurori t'i diskutojë dilemat me eprorin e tij, me ndonjë koleg ose me ndonjë person në të cilin ka besim.

## 1. Pavarësia

Prokurori duhet të veprojë në mënyrë të pavarur gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe vlerësimin e lirë të fakteve, pa kufizime, ndërhyrje, presion ose kërcënim nga çdokush dhe për çfarëdo arsye.

Prokurori mbështetet nga shoqëria, duhet të jetë i pavarur gjatë punës së tij dhe të marrë vendime bazuar në arsyet objektive.

Interesi personal i prokurorit duhet t'i nënshtrohet interesit publik dhe nuk mund të udhëhiqet nga interesi i tij personal dhe nga motive të papërshtatshme.

### Zbatimi

- a. Prokurori ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur në bazë të vlerësimit të saktë të fakteve dhe në përputhje me Kushtetutën, si dhe bën zbatimin e drejtë të ligjit, i pandikuar nga brenda dhe jashtë;
- b. Prokurori shmang çdo përpjekje të parregullt dhe të paligjshme, e cila mund të ndikojë në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tij;
- c. Prokurori nuk kërkon dhe nuk pranon përfitime materiale apo jomateriale për vete, familjarët e tij, persona të tretë dhe institucione, interesa të

- lidhura drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë me rezultatin e procedimit apo çështjes që ka në ndjekje;
- d. Prokurori nuk zhvillon veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar për interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tij dhe mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tij ose personave të tjerë, si dhe nuk duhet të anëtarësohet në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se komprometojnë figurën e prokurorit dhe janë të papajtueshme me funksionin e tij;
  - e. Prokurori nuk ndikohet nga interesat e grupeve të caktuara dhe presionet e mediave dhe të publikut;
  - f. Prokurori respekton të drejtat e të gjithë personave për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe shmang diskriminimin e çdo personi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike apo bindjeve të tjera, orientimit seksual, origjinës shoqërore apo kombëtare, lidhjes me një pakicë kombëtare, pasurisë, lindjes, statusit aspektit shëndetësor apo ndonjë aspekti tjetër statusor;
  - g. Prokurori duhet të përmbahet nga çdolloj sjelljeje që mund të nxitë dyshime se është person politik.

## 2. Paanshmëria

Prokurori duhet të sigurojë të drejtat e të gjithë personave gjatë ushtrimit të funksionit në vazhdimësi për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe të veprjë me objektivitet e paanshmëri, duke shmangur çdo diskriminim dhe paragjykim në lidhje me përkatësinë politike, etnike, sociale, kulturore, fetare ose gjinore, orientimin seksual, moshën, statusin, paaftësinë fizike apo mendore.

### Zbatimi

- a. Prokurori nuk lejon që i dyshuari apo i pandehuri të bëhet objekt dhune, presioni apo torture, sidomos për ta detyruar atë të fajësojë veten apo ta shpallë fajtor me anë të shpjegimeve të siguruara në kundërshtim me ligjin;
- b. Prokurori është i paanshëm dhe duhet të veprjë kështu gjatë gjithë kohës, në mënyrë që të duket dhe perceptohet si i tillë nga opinioni publik;
- c. Prokurori respekton parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtat e personit nën hetim apo në çdo fazë tjetër gjatë procedimit penal;
- d. Prokurori tejkalon paragjykimet kulturore dhe çdo paragjykim tjetër që mund të nd-

- ikojë në kuptimin, vlerësimin e fakteve, interpretimin dhe zbatimin e ligjeve;
- e. Prokurori duhet të jetë tolerant dhe i hapur për diskutime dhe zgjidhje të ofruara në mënyrë të ligjshme dhe të marrë parasysh pikëpamjet, interesat ligjore, jetën private dhe shqetësime të tjera të personave, që i kontakton gjatë punës së tij zyrtare;
  - f. Prokurori nuk ofron ndonjë shërbim ligjor për familjarët e tij dhe të afërmit, përveç rasteve të mbrojtjes së të drejtave personale;
  - g. Prokurori duhet të shmangë çdo aktivitet, i cili ndikon negativisht në paanshmërinë e tij gjatë kryerjes së funksionit si prokuror, të mbledhë mjete financiare, të japë këshilla juridike në lidhje me investimet financiare dhe të japë kontribut financiar për subjektet politike;
  - h. Prokurori duhet t'i shmangë diskutimet publike dhe nënshkrimin e peticioneve që mund të kenë ndikim në ndonjë vendim politik;
  - i. Prokurori nuk komenton publikisht dhe privatisht lëndët në procedurën penale, të cilat nxisin dyshimin e paanshmërisë, përfshirë edhe procedurën gjyqësore;
  - j. Prokurori do të kërkojë përjashtimin e tij nëse te publiku mund të krijojë përshtypjen

ose vlerëson vetë se nuk është në gjendje të vendosë në mënyrë të paanshme në një lëndë të caktuar.

### 3. Integriteti

- 3.1. Integriteti është cilësi e prokurorit, e cila duhet të jetë e dukshme dhe e njohur gjatë tërë kohës në harmoni me veprimet e tij, të bazuara në karakterin e lartë moral dhe profesional. Të vepruarit me integritet për një prokuror do të thotë të punojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në jetën profesionale dhe private.
- 3.2. Shkelja e integritetit mund të përfshijë një veprim ose mosveprim, qoftë gjatë ushtrimit të detyrës dhe në jetën private, që është në kundërshtim me ligjin, politikat dhe strategjitë e sistemit prokurorial, udhëzimet administrative, ose një veprim që përbën vepër penale.

#### Zbatimi

- a. Prokurori duhet të ketë qëndrim dhe qasje të paanshme gjatë ushtrimit të detyrave të tij në çdo kohë. Prokurori nuk duhet të veprojë në bazë të interesave personale, interesave apo preferencave të personave të njohur, anëtarëve të familjes ose interesave

- të bizneseve apo interesave politike. Për më tepër, në asnjë rast nuk duhet që interesat personale ta udhëheqin atë në avokimin e ndonjë pozicioni, i cili është në kundërshtim me faktet dhe ligjin e zbatueshëm;
- b. Prokurori nuk lejon që presioni i medias të ketë ndikim në vendimmarrjen e tij;
  - c. Prokurori përjashton çdo sjellje që mund të ngjallë dyshime lidhur me paanshmërinë e motiveve të tij dhe nuk përfshihet në sjellje që dëmtojnë nderin dhe dinjitetin e Prokurorit të Shtetit, si dhe mund të dëmtojnë besimin e publikut;
  - d. Prokurori nuk angazhohet në raste të veprave penale kur si i dyshuar, palë raportuese ose dëshmitar përfshihet ndonjë i njohur, anëtar i familjes ose i marrëdhënies së biznesit;
  - e. Përveç në rastet kur lejohet, prokurori nuk e shfrytëzon për qëllime private pasurinë e Prokurorit të Shtetit dhe nuk merr ndonjë pronë të tillë në shtëpi përveç për qëllime zyrtare;
  - f. Prokurori duhet të shmangë çdo kontakt dhe aktivitet privat ose biznesor, i cili mund të ngjallë dyshime për punën e tij në Prokurorinë e Shtetit. Kjo vlen gjatë ushtrimit të detyrës dhe në jetën private;
  - g. Prokurorët mund të jenë anëtar të Shoqa-

tës së Prokurorëve apo shoqatave të tjera, të cilat i mbrojnë interesat dhe promovojnë vlerat e sistemit të drejtësisë;

- h. Prokurori nuk do të angazhohet në asnjë funksion, aktivitet dhe veprimtari politike, përfshirë anëtarësinë në parti politike ose kandidimin apo mbajtjen e një pozite politike. Prokurori inkurajohet të votojë, por nuk mund të marrë pjesë për t'u zgjedhur në funksione politike;
- i. Prokurori nuk mund të kryejë veprimtari, të cilat nuk përkojnë me reputacionin e institucionit dhe ndikojnë negativisht në besimin profesional dhe publik në sistemin prokurorial, përveç aktiviteteve shtesë, të lejuara me Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Në rast të angazhimit në këto aktivitete plotësuese (duke përfshirë pjesëmarrjen në organizata profesionale dhe takime shkencore që promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesit profesional të prokurorëve, si dhe angazhimin në shkrimet profesionale dhe shkencore) mund të kompensohen në vlerën e njëzet e pesë për qind (25%) të pagës bazë për pjesëmarrje në këto veprimtari;
- j. Prokurori mund të angazhohet në veprimtari joprokuroriale gjatë orarit të punës, si në: Akademinë e Drejtësisë për trajnimin e



prokurorëve dhe gjyqtarëve, por edhe në raste të tjera kur është paraparë me ligje të posaçme;

- k. Prokurori nuk mund të kërkojë dhe të pranojë çfarëdo forme të dhuratave, shpërblimeve dhe avantazheve të tjera të padrejta për veten ose për ndonjë person tjetër, që mund të çojnë ose duket që çojnë në ndikim të pahijshëm në vendimet dhe veprimet zyrtare, përveç në rast të ndonjë vizite protokollare dhe të ngjashme. Prokurorit i lejohet të marrë dhurata të rastit. Dhurata të rastit konsiderohen dhuratat e vogla me vlerë deri në 25 euro. Prokurori nuk mund të pranojë dhurata të rastit, vlera e përgjithshme e të cilave tejkalon shumën prej 500 eurosh brenda një viti<sup>1</sup> dhe nuk mund të pranojë më shumë se një dhuratë në vit nga i njëjti person ose institucion<sup>2</sup>. Dhuratat protokollare dhe dhuratat e rastit, të cilat nuk janë të karakterit personal bëhen pronë e institucionit<sup>3</sup>;
- l. Prokurori tregon respekt për detyrat që duhet të kryhen nga profesionistët e tjerë në sistemin e drejtësisë penale. Ai respekton

---

1 Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

2 Ligji i sipërpërmendur.

3 Ligji i sipërpërmendur.

faktin se avokatët dhe gjyqtarët mund të arrijnë në përfundime të tjera nga pikëpamjet e roleve të tyre përkatëse;

- m. Në marrëdhënien e tij me një gjyqtar, prokurori duhet që: të respektojë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve; nuk duhet të hedhë dyshime për vendimet gjyqësore dhe nuk duhet ta pengojë ekzekutimin e tyre, përveçse kur ushtron të drejtat e tij në mjetet juridike dhe kur kërkon ndonjë procedurë tjetër në përputhje me ligjin.
- n. Prokurori duhet të jetë objektiv dhe i drejtë gjatë procedurave gjyqësore.
- o. Prokurori duhet të përmbahet nga kritikrat publike ndaj gjyqtarëve në mënyrë të papërshtatshme;
- p. Prokurori në marrëdhëniet e tij me policinë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit duhet të japë udhëzime të qarta dhe të ligjshme.

### 3.3. Konfidencialiteti

Prokurori i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit. Ky detyrim nënkupton se ai nuk ofron ndonjë informacion, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që do të zbulonte sekrete zyrtare, që do të rrezikonte një hetim në pritje ose procedim penal, që do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat e privatësisë së çdo personi, ose

që do të shkelte të drejtat e të miturve<sup>4</sup>.

## Zbatimi

- a. Prokurori mbron konfidencialitetin e informacioneve;
- b. Detyrimi i konfidencialitetit e obligon prokurorin që jo vetëm të mos “nxjerrë” ose komunikojë ndonjë informacion konfidencial, por edhe që të kujdeset të mos lërë informacione të tilla të pambrojtura dhe të mos lejojë që të tjerët të kenë qasje në informacionet e tilla;
- c. Prokurori përdor informacion vetëm për qëllimin për të cilin është ofruar ai informacion;
- d. Prokurori nuk ndanë informacionet lidhur me një rast me ndonjë familjar, mik, të njohur apo palë të tretë të paautorizuar.

## 4. Llogaridhënia dhe transparenca

Llogaridhënia dhe transparenca janë vlera themelore për prokurorin, të cilat nënkuptojnë kryerjen e detyrave në nivel të lartë, profesional, të përgjegjshëm, transparent dhe efikas. Prokurori duhet të japë llogari gjatë ushtrimit të funksionit dhe për mënyrën e ushtrimit të tij. Prokurori gjatë ushtrimit të funksionit të tij, prioritet ka detyrën e prokurorit, kundrejt aktiviteteve të tjera.

### Zbatimi

- a. Prokurori do të ofrojë informacione relevante për palët në procedurë, gjithashtu, prokurori do të kërkojë informacione që mund të jenë relevante për llogaridhënien, e cila kërkohet për zgjedhjen dhe kryerjen e veprimeve të tij;
- b. Prokurori duhet të marrë parasysh edhe interesat e tjera, siç janë interesat e hetimit, prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve të përfshirë në procedurën penale. Kjo do të thotë që një prokuror mund të ballafaqohet me dilemën se cilat interesa konsiderohen të kenë rëndësi më të mëdha në një situatë konkrete. Nëse rezulton se asgjë nuk duhet të zbulohet në lidhje me rastin ose të paktën ende jo, parimi

- i transparencës kërkon që arsyet për këtë veprim të jenë të qarta në çdo rast;
- c. Prokurori trajton me kujdes informacionet, nuk fsheh dhe nuk manipulon me ndonjë informacion relevant. Megjithatë, nëse ka arsye të qëndrueshme për të mos bërë të ditur ndonjë informacion specifik, kjo do të bëhet në mënyrë të hapur dhe duke deklaruar arsyet, me ç' rast prokurori duhet ta regjistrojë këtë. Prokurori duhet të jetë në gjendje të justifikojë në çdo kohë përdorimin ose mospërdorimin e informacioneve të caktuara.

#### 4.1. Transparenca dhe mediat

Prokurori është në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, prandaj institucioni i Prokurorit të Shtetit është i arritshëm dhe i afërt për mediat. Për prokurorët, kjo nënkupton se gjithmonë duhet të marrin parasysh faktin se një rast në të cilin kanë qenë duke punuar mund të shfaqet në media. Kjo nënkupton gatishmërinë për të qenë transparent në lidhje me rastin nëse një gjë e tillë kërkohet nga udhëheqësit. Gjatë paraqitjeve në media, prokurori duhet të përmbahet nga dhënia e informatave lidhur me rastet konkrete përveç rasteve kur ka autorizim për një gjë të tillë.

Për qëllime të dhënies së informatave për me-

diat, prokurori duhet t'i respektojë udhëzimet e brendshme përkatëse në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Ai duhet të përmbahet nga cilido kontakt me mediat pa pëlqimin apo autorizimin e kërkuar.

## 5. Profesionalizmi

Profesionalizmi është një nga vlerat themelore që nënkupton se prokurori duhet të ketë nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ta ushtrojë funksionin e tij në përputhje me përgjegjësitë që burojnë nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

### Zbatimi

- a. Prokurori duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat që janë në favor dhe në dëm të të pandehurit, mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve, personave të dënuar dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
- b. Prokurori përcjellë praktikën relevante në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare që nënkupton konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe liritë e njeriut;
- c. Prokurori zbaton standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve

- zyrtare;
- d. Prokurori duhet të bëjë sjellje të ndershme dhe profesionale në punën zyrtare dhe jetën private bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale;
  - e. Prokurori duhet që t'i përcaktojë qëndrimet e tij shpejt, qartë dhe vendosmërisht, sidomos në kontaktet e tyre me policinë dhe palët në procedurë;
  - f. Prokurori duhet të jetë gjithmonë i gatshëm t'i zëvendësojë kolegët kur një gjë e tillë kërkohet nga ai;
  - g. Prokurori gjithmonë duhet të jetë i përgatitur gjatë përfaqësimeve në Gjykatë;
  - h. Prokurori duhet të veprojë me respekt kur ndërvepron me të tjerët, si në marrëdhëniet e tyre me qytetarët dhe palët e jashtme, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me kolegët, duke përfshirë edhe eprorët dhe vartësit;
  - i. Prokurori duhet të synojë që të ketë marrëdhënie të mira me kolegët e tij dhe të përqendrohet në bashkëpunimin, frymën ekipore, transparencën dhe qëndrimin e orientuar ndaj shërbimeve;
  - j. Prokurori duhet të përmbahet nga dhënia e komenteve dhe mesazheve që mund ta dëmtojnë nderin dhe reputacionin e institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe mund të dëmtojnë

- besimin e publikut në paanshmërinë dhe besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit;
- k. Prokurori duhet të jetë i vetëdijshëm se mbajtja e kontakteve të caktuara në jetën e tij private mund të jetë në kundërshtim me sjelljen etike dhe mund të dëmtojë reputacionin e Prokurorit të Shtetit;
  - l. Prokurori duhet të ofrojë një mjedis profesional dhe kolegial, në të cilin dilemat diskutohen gjithmonë. Vetë prokurori e merr iniciativën për veten e tij, i ndihmuar nga eprorët brenda institucionit të Prokurorit të Shtetit.

## 6. Zbatimi dhe hyrja në fuqi

Kodi i Etikës hyn në fuqi me datën 1 mars 2019. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës më 31 korrik 2012.

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi zhvillohen dhe përfundojnë sipas Kodit Etikës dhe Sjelljes Profesionale të datës 31 korrik 2012.





Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Tužilački Savet Kosova  
Kosovo Prosecutorial Council

[www.kpk-rks.org](http://www.kpk-rks.org)



Prokurori i Shtetit  
Državni Tužilac  
State Prosecutor

[www.psh-ks.net](http://www.psh-ks.net)

